



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 14.10.2025

Njoftim për vende vakante në shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Në zbatim të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 93, datë 12.6.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë si dhe pranimin në shërbimin civil për pozicionet:

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD për Masën 1, Masën 3, Masën 7 dhe Masën 9, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës: III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6912>

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Skemave Kombëtare, në Drejtorinë e Kontrollit, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6913>

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Identifikimit të Mashtrimit dhe Parregullsive, në Drejtorinë e Parandalimit të Mashtrimit, Parregullsive dhe Riskut, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6914>

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6915>

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Studimit të Tregut, në Drejtorinë e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6916>

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil 2 (dy) pozicion Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6917>

Janë të ftuar të gjithë nëpunësit e interesuar, pjesë e shërbimit civil apo kandidatë për pranim në shërbimin civil të aplikojnë për pozicionin vakant të shpallur. Në lidhjet përkatëse, mund të gjeni informacionin e plotë për kriteret, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit, si dhe përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin/et.

Për më shumë informacion ndiqni faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në lidhjen:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL